



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr _____ Prot

Vlorë, më ____ . ____ 2022

Procesverbal

Nr 14, datë 30.11.2022.

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria “. (Ora 10³⁵)

Marrin pjesë:

- | | |
|----------------------|---------------------|
| 1.Edison Kapaj | 16.Andi Resulaj |
| 2.Ramona Jaho | 17.Kasëm Mahmuti |
| 3.Sokol Kushta | 18.Liljana Breshani |
| 4.Jonela Halili | 19.Kristaq Meçi |
| 5.Migena Balla | 20.Gentian Hamzaraj |
| 6.Elona Toçaj | 21.Briseida Çakëri |
| 7.Anisa Shametaj | 22.Bujar Osmanaj |
| 8.Ervis Moçka | 23.Rozina Kormuzi |
| 9.Simo Petromilo | 24.Grigor Dede |
| 10.Frosina Qyrdeti | 25.Teki Xhemalaj |
| 11.Englantina Imeraj | 26.Asime Feraj |
| 12.Ardian Skëndaj | 27.Lindrit Beqiraj |
| 13.Kreshnik Tepelena | 28.Evis Allushi |
| 14.Arben Meksi | 29.Roneda Muçaj |
| 15.Istref Dobi | |

Mungojnë :

- 1.Klearda Rapushi
- 2.Ina Islamaj

- 3.Brunilda Saliaj
- 4.Alboren Aliaj
- 5.Ervis Caushaj
- 6.Julian Bleta
- 7.Sulltana Bilbilaj
- 8.Klara Bajaziti
- 9.Rudi Pashaj
- 10.Edlira Kapllanaj
- 11.Sulejmën Bubeqi
- 12.Fatos Rukaj
- 13.Besian Gega
- 14.Paula Sullaj
- 15.Jerina Dervishaj
- 16.Brunilda Cani
- 17.Anxhela Aliraj
- 18.Mujo Shakaj
- 19.Adiola Gjoka
- 20.Pëllumb Nezha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr _____ Prot

Vlorë, më ____ . ____ 2022

Procesverbal
Nr 14/1, datë 30.11.2022.

Znj.Migena Balla - Kuorumi u plotësua. Fillojmë mbledhjen. Para se të fillojmë, dua të them se, kemi humbur një punonjës nga administrata, një specialist dhe njeri shembullor, shumë korrekt, kështu që është dhe propozimi i z.Simo , të mbajmë 1 minutë heshtje. (Mbahet 1 minutë heshtje në nder dhe respekt të z.Petro Thanasko , specialist në administratën e bashkisë) .

- I paharruar.

Fjalën e ka zonja Jonela , në lidhje me shprehjen e ligjshmërisë.

Znj.Jonela Halili – Me dokumentin administrativ , ardhur nga institucioni i prefektit të qarkut , vendimet e këshillit të bashkisë të mbledhjes së kaluar, datë 30.11.2022, Nr 78,79,80 , janë vlerësuar të ligjshëm.

Z.Ardian Skëndaj – Sot , si dhe herën e kaluar , mungojnë pjesa më e madhe e administratës. Kujt do t’ia tregojmë problematikat ? Kemi probleme që kemi ngritur dhe do ngrejmë. Nuk kemi vetëm rend dite.

Znj.Migena Balla – Keni të pranishëm drejtorët që kanë materiale, që kanë projekt vendime.

Z.Ardian Skëndaj – Duhet te vijnë , të gjithë , jo vetëm ata që kanë materiale, projekt vendime.

Kujt do ti drejtohem, qyteti ka shumë probleme.

Znj.Migena Balla – Do komunikojmë, do marrim informacion.S’kam informacion.

Atëherë, jeni njohur të gjithë me rendin e ditës. Pra, përmban 7 pika.

Keni gjë në lidhje me rendin e ditës ? – Jo.

E hedhim në votë. Votohet.

Pro – 26 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.

Kalojmë në pikën 1 të rendit të ditës, në “Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së këshillit bashkiak, datë 28.10.2022. “

Jeni njohur, e keni dhe me e-mail.

Keni gjë pyetje, diskutime ? – Jo.

Votohet.

Pro – 26 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr _____ Prot

Vlorë, më ____ . ____ 2022

Procesverbal
Nr 14/2, datë 30.11.2022.

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 2 të rendit të ditës, në miratimin e projekt vendimit “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e bashkisë për muajin tetor 2022”.

Nga administrata, një relacion, zonja Irena .

Znj.Irena Stasa - Këto familje që dalin nga skema dixhitale , nga verifikimet e bëra nga administratoret, i planifikojmë me të ardhurat e bashkisë.

Përfitojnë 42 familje me kushte të vështira social ekonomike.

Bashkia Vlorë, ose qendër (me 5 rajonet) – 30 familje.

Njësia Shushicë – 3 familje.

Njësia Qendër – 5 familje.

Njësia Orikum – 2 familje.

Njësia Novoselë – 2 familje , pra 42 familje përfituese.

4 familje dalin nga skema e ndihmës ekonomike. Janë dhe familje që e përfitojnë për herë të parë.

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutimë ? - Jo.

Votohet.

Pro – 27 vota. (Vjen z.Lindrit Beqiraj)

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
KËSHILLI BASHKIAK

Nr _____ Prot

Vlorë, më ____ . ____ 2022

Procesverbal
Nr 14/3, datë 30.11.2022.

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 3 të rendit të ditës, në miratimin e projekt vendimit
“Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin tetor 2022”.

Një relacion nga zonja Irena .

Znj.Irena Stasa - Përfitojnë 17 familje, ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar, fond i cili vjen nga qeveria.

Z.Migena Balla – Pyetje, diskutime ? - Jo.

Votohet.

Pro – 28 vota(vjen zonja Evis Allushi)

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
KËSHILLI BASHKIAK

Nr _____ Prot

Vlorë, më ____ . ____ 2022

Procesverbal
Nr 14/4, datë 30.11.2022.

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 4 të rendit të ditës, në miratimin e projektit vendimit “ Për një ndryshim në Vendimin Nr. 80 datë 02.12.2021 të Këshillit të Bashkisë Vlorë “ Për përcaktimin e disa kundravajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Vlorë “.

Ka njeri për relacion ?

Znj.Liljana Breshani - Inskënim, shumë e turpshme në lidhje me këtë projekt vendim. Nuk dimë ku jetojmë.

S’kemi marrë masa për sterilizimin e kafshëve të rrugës. E kemi miratuar si fond.Drejtoria e veterinarisë nuk ka bërë punën. Duam të jetojmë të qetë në qytetin e Vlorës. Është projekt vendim i paplotë dhe i pakuptimtë. Kam kërkuar nga drejtoria e veterinarisë relacion, në lidhje me këtë fond për sterilizimin e kafshëve endacake. Nuk është bërë asgjë, rrugët janë plot. Kam lobuar dhe do vazhdoj të loboj.

Z.Ervis Moçka – Nuk di. Është problem që nuk ka njeri për ta referuar ? Mesa shoh, është një projekt vendim që sjell ndryshim në rregullore, jo për të vënë gjoba. Ato janë. Më parë i vendoste agjencia e veterinarisë dhe tani policia bashkiake . S’ka lidhje me çka diskuton zonja Liljana . Ky projekt vendim, thjesht, është ndryshimi.

Z.Liljana Breshani – Për çfarë është ky sektor.

Z.Ervis Moçka – Po shpjegoj ligjërisht. Agjencia e veterinarisë që vendos gjobat, sot , me anë të këtij projekt vendimi do ta bëjë policia bashkiake. Po flas ligjërisht.

Z.Ardian Skëndaj - Unë sjam dakort. Se ndodh dhe, policia bashkiake, nuk di si do funksionojë. Do të ndodhë si me agjentët tatimorë, që nuk mbledhin asnjë detyrim.

Z.Ervis Moçka – Pra, për ta votuar mendoj 2 propozime : Ose kundër projekt vendimit dhe nuk gjen efekt dhe propozimi i dytë , mos ta hedhim në votë që, nuk u sqarua nga ana procedurale nga administrata.

Znj.Jonela Halili – Në kushtet që nga administrata , nuk ka njeri për ta relatuar , mendoj ta shtyjmë për një mbledhje tjetër, mos ta kalojmë sot.

Znj.Migena Balla – Kush është dakort , ta shtyjme projekt vendimin për mbledhjen tjetër ?
Votohet.

Pro – 29 vota(vjen znj.Roneda Muçaj).

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Pra, shtyhet për një mbledhje tjetër.

Znj.Liljana Breshani - Duhet të njihemi me Ligjin e Veterinarisë , nga agjencia veterinare, pastaj gjobat.

Z.Simo Petromilo - Lidhur me këtë problem, lidhur me shërbimin veterinar, disa kompetenca i kanë kaluar agjencisë veterinare, disa agjencisë së ushqimit..., pra krijohet një antikap.

Pra, Ministria e Bujqësisë, (lexon)..... sipas ligjit të shërbimit veterinar , ka të drejtë të gjobisë.

Pra, përveç akt konstatimit, ata nuk kanë të drejtë të gjobisin. Jam dakort ta rishikojmë , ta kalojmë në seancë tjetër.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr _____ Prot

Vlorë, më ____ . ____ 2022

Procesverbal
Nr 14/5, datë 30.11.2022.

Znj.Migena Balla - Kalojmë në pikën 5 të rendit të ditës, në miratimin e projekt vendimit
“ Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e znj.Anila
Petanaj në datën 18.08.2022 dhe, shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë”.

Nga administrata , zoti Vreshtazi, një relacion.

Z.Adrian Vreshtazi – Drejtorja e Emergjencave Civile, vjen me këtë projekt vendim për dhënien,
miratimin e vlerës financiare nga djegia në banesën e znj.Anila Petanaj.

Zbatojmë VKM Nr 329 për procedurë dhe, fillimisht, fillon me kërkesën nga vetë qytetari,
pastaj nga preventivat nga specialistët e qarkut. Kjo vlerë mbulohet nga buxheti i bashkisë .

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime ? – Jo.

Kalojmë në votim.

Pro – 29 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr _____ Prot

Vlorë, më ____ . ____ 2022

Procesverbal
Nr 14/6, datë 30.11.2022.

Znj.Migena Balla - Kalojmë në pikën 6 të rendit të ditës, në miratimin e projekt vendimit “Për miratimin e programit të punës së Këshillit Bashkiak Vlorë, për periudhën janar 2023 – dhjetor 2023”.

Znj.Migena Balla - Është një projekt vendim rutinë, bazuar në ligjin Nr 139 ..Është projekt vendim në lidhje me planin e aktiviteteve të këshillit bashkiak, lidhur këto me takimet, dëgjuesat me publikun..Do bashkëpunojmë me drejtoritë në lidhje dhe me sjelljen e materialeve në afat. Është plan aktiviteteve , që mund të rishikohet. Materialet i keni pas, i keni parë.
Kush ka pyetje, diskutime ? – Jo.

Kalojmë në votim.

Pro -29 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA V Lorë
KËSHILLI BASHKIAK

Nr _____ Prot

Vlorë, më ____ . ____ 2022

Procesverbal
Nr 14/7, datë 30.11.2022.

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës, të ndryshme.Kush e do fjalën ?

Z.Ardian Skëndaj – Mbledhjen e kaluar, kërkova informacion në lidhje me ndarjen e apartamenteve. Akoma nuk na ka ardhur gjë. Këto banesa, do ti shkojnë atij që i takon.

Dini gjë Ju zonja kryetare ?

Znj.Migena Balla – Përveç bisedës që pata me zonjën Drita ...

Z.Ardian Skëndaj – Ne jemi mirëkuptues dhe bashkëpunues. Do ti bëjmë një shkresë kryetarit të bashkisë.

- Drejtoreshë, sa lekë mblidhen nga uji që përdorin për bujqësinë ? Mblidhen zero lekë.

Znj.Erinolda Lushaj – Banorët mbledhin një taksë, për rregullimin e rezervuarit, riparime si për saraçineska etj... Nuk ka patur një numër llogarie, thjesht janë mbledhur dhe përdorur për riparimet e nevojshme.

Z.Ardian Skëndaj – Kemi miratuar investimet, nuk i nxjerrin nga xhepi.

Znj.Erinolda Lushaj – Po, investime ka patur.

Z.Bujar Osmanaj – Tek zëri kullimi, vaditja, ujitja ..., planifikimi ka qenë rreth 3miljon e 600 mijë ...Çna duhet kjo shifër, kur ajo mblidhet atje. Njësitë Qendër dhe Shushicë, vadin nga lumi i Shushicës...Të paktën mos të na vijë zë në buxhet, kjo shumë 3miljon e 600 mijë lekë. Le ti përdorin, por mos të na vijë ne kjo vlerë në buxhet.

Z.Ardian Skëndaj – Drejtoresha do na sjellë një relacion , pasi të marrë një informacion.

Z.Grigor Dede – Duke qenë se mbledhjen e radhës do të na vijë projekt buxheti, para tij duhet të na vijë projekt vendimi i strukturës . Mendoj , të na vijë më parë ky projekt vendim.

Z.Sokol Kushta - Ne po flasim shumë . Nuk ndihemi mirë dhe me qytetarët që, kërkojmë gjithmonë zgjidhje dhe s'kthehet përgjigje, s'bëhet asgjë. Mendoj ta mbyllim.

Znj.Migena Balla - Keni gjë tjetër në lidhje me këtë pikë ? – Jo.
Atëherë, mbledhjen e konsideroj të mbyllur.
Faleminderit .

Mbajti Procesverbalin
Zhaneta Gjika